REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 71/17
Datë/Datum. 10.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Kamenicës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **me numër të prokurimit KM653 16 019 221**

Sa i përket tenderit për **HARTIMI I HARTES ZONALE TË KOMUNËS**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Instituti për Shkencë dhe Teknologji "INSI" Sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Qendra e re tregtare në Prishtinë Nr.42
(Adresa)

Prishtinë *(Vendi)*

10000 *(Kodi postar)*

044999007 *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Ismajl Baftijari
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baftijari@gmail.com
(Adresa elektronike)

09.03.2017
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

INSTITUTI SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË "INSI" Sh.p.k. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: ***n/a***

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë i publikuar në KRPP: 12.08.2016

Afati për dorëzim të tenderit dhe hapja: 01.09.2016, ora 14:30

Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët

Njoftimi për dhënie në KRPP: 01.03.2017

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Më datën 03.03.2017, Instituti për Shkencë dhe Teknologji INSI ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues Komuna e Kamenicës (*shih të bashkëngjitur kërkesën për rishqyrtim*)

Më datën 06.03.2017 Autoriteti Kontraktues Komuna e Kamenicës merr vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim të bërë nga INSI (*shih të bashkëngjitur Vendimin për refuzim)*

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave, ka shkelur dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik, Neni 59. duke mos bërë vlerësim objektiv për këtë procedurë.**
- **Në bazë të të dhënave të cilat i posedojmë, edhe operatori ekonomik Vision Projekt, menaxherin e kontratës Shkëlqim Osmani, e ka përfshirë në listen e stafit, ashtu siç ka vepruar OE "INSI".**
- **Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) për një veprim të tillë në vendimin nr. 475/16 të datës 09.02.2017** *(shih vendimin e bashkëngjitur),* **vlerëson se operatori ekonomik INSI është i papërgjegjshëm sepse ka vepruar jo në pajtim me kërkesat e Autoriteti Kontraktues, duke potencuar se** ***(citojmë)*** *"emrin e menaxherit e ka vendosur edhe te lista e inxhinierëve tjerë, e që normalisht në bazë të kërkesës është dashur që në atë listë të vendosen emrat e inxhinierëve të tjerë të kualifikuar sipas kërkesës së dosje së tenderit dhe të njoftimit për kontratë" (mbaron citati),* **atëherë e njëjta gjë është dashur të të vlejë edhe për operatorin ekonomik Vision Projekt. Vlerësojmë se edhe OSHP, ashtu sikurse edhe Autoriteti Kontraktues, nuk i ka trajtuar operatorët ekonomik në pajtim me Nenin 7 të LPP:**

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

- **Pas qasjes në dokumentacion për këtë lëndë, kemi parë se edhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit e kanë theksuar këtë shqetësim se të dy operatorët**

ekonomik e kanë të njëjtin lëshim në përmbushje të kërkesës për Aftësitë teknike dhe profesionale, por Autoriteti Kontraktues nuk i ka marrë parasysh mospajtimet e tyre të bazuara në fakte. *(shih faksimilet e bashkëngjitura)*

- **Autoriteti Kontraktues Komuna e Kamenicës, bie edhe në Kundërshtim me Vendimin e OSHP-së, pasi që operatorin e ekonomik INSI e vlerëson të përgjegjshëm** *(shih letrën standarde për operatorin ekonomik të pasuksesshëm)*, **vetëm e vetëm që të ketë arsye që edhe operatorin e ekonomik Vision Projekt ta shpallë të përgjegjshëm, duke ditur se ai kishte ofruar çmim më të ulët dhe kështu do të "plotësoheshin' kushtet për ta përzgjedhur fitues, në vend se në këtë rast të korrigjonte lëshimin (teknik) favorizues të OSHP-së të bërë ndaj operatorit ekonomik Vision Projekt.**
- **Pasi që AK mbetet edhe më tej në qëndrimet e saj** *(shih vendimin për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim)*, **ne parashtruam këtë ankesë në OSHP, por edhe do t'i njoftojmë organet tjera të cilat do të merren lidhur me shkeljet e bëra nga Autoriteti Kontraktues - Komuna e Kamenicës.**
- **Me këtë rast kërkojmë Organi Shqyrtues i Prokurimit të urdhërojë Autoritetin Kontraktues Komuna e Kamenicës, që të bëjë anulimin e procedurës, duke u bazuar në gjendjen faktike reale të ofertave, e jo një operator ekonomikë ta favorizojë, ndërsa tjetrin ta ndëshkojë padrejtësisht, siç ka vepruar në këtë rast.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

- **Vendimi i AK Komuna e Kamenicës për Refuzim të kërkesës për Rishqyrtim**
- **Kërkesa për Rishqyrtim**
- **Vendimi OSHP-së**
- **Letrat e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit**
- **Kopjet e ofertës së OE "Vision Projekt", lista e stafit dhe caktimi i Menaxherit**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- **Me këtë veprim Autoriteti Kontraktues na ka shkaktuar dëme materiale për angazhim të stafit në përgatitje të ofertës, angazhim të ekspertëve në analiza të ndryshme.**
- **Po ashtu dyshojmë se metodologjia e Punës, Plani dinamik dhe pjesa më e madhe e punës për Fazën e Dytë të cilat ishin pjesë e tenderit tonë, mund të shfrytëzohet nga të tjerë operatorë ekonomikë, duke na shkaktuar dëme materiale dhe dëme në konkurrencën e mëtejme për projekte të kësaj natyre.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) ***një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"***
b) ***një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës"***
c) ***një kopje të letrës së tenderuesit të pasuksesshëm***
d) ***vendimi i OSHP-së***
e) ***dëshmi të tjera nga oferta e OE Vision Projekt***
f) ***dëshmi të anëtarëve të vlerësimit etj.***
g) ***kërkesa për Rishqyrtim***
h) ***vendimi i AK Komuna e Kamenicës për Refuzim të kërkesës për Rishqyrtim***

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*